



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL - MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA	
AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS - AGJENCIA ZA ŠUME KOSOVA - KOSOVO FOREST AGENCY	
DREJTORIA E INSPEKTORATIT TË PYLLTARISË DHE GJUETISË - DIREKCIJA ZA INSPEKCIU ZA SUMARSTVO I LOVSTVO - DIRECTORATE FOR INSPECTION OF FORESTRY AND HUNTING	
Nr. i Org. Org. Jednica Org. Unit	DQIPGJ
Nr. i Faqëve Bë. Stranica No. Pages	8
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	67/21
Data Datum Date	05.07.2021
PRISHTINË/A	

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT



Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Drejtoria Qendrore e Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë
Adresa: Lagja e spitalit, Rruga Ernest Koliqi, 10000- Prishtinë (Përballë EULEX-it)
Tel. 038/200/38-383

	Ref: DQIPGJ- /'21
	DATË: / /2021
PËR/ZA/TO:	PROKURORISE THEMELORE NË FERIZAJ Prokurorit të Shtetit në Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Besim Zogu, Drejtor i Drejtoratit Qendror të Inspektionit të Pylltarisë dhe Gjuetisë në APK-ës
NGA/OD/FROM:	Mehdi Berisha, Inspektor në, DQIPGJ
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	"Kallëzim penal" roje pylli, në Autoritetin Pyjor Komunal në Ferizaj.

Në bazë të Nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Inspeksionin Bujqësor Nr. 03/L-029, Neni 8 paragrafi 1.13, Udhëzimit Administrativ për Autorizimet dhe Kompetencat e Inspektionit Pyjorë dhe Procedurat e Nxjerrjes së Vendimeve, MA-Nr. 03/2006, Inspektorët e Pylltarisë paraqesin këtë:

KALLËZIM PENAL

Kundër:

ë cilësinë e rojës së pyllit në Autoritetin Komunal të Pyjeve në Komunën Ferizaj, i lindur me datë: Komuna Ferizaj, me nr. Adresa e banimit: ndërtesa

Inspektorët e Pylltarisë nga Drejtoria Qendrore e Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë (DQIPGJ), kanë ushtruar gjatë vitit 2020 inspektime në pyjet e Ferizajit, ndërsa me datë 18/02/21 në zyrën e z.Lumni Salihu Përgjegjës në APK-al. në kuadër të Drejtorisë për BP. K.Ferizaj, kemi kërkuar çdo dokumentacion lidhur me revizione të terreneve për vitin 2020, ku kemi pasur dyshime se kishte dëme të mëdha me prerje pyjesh si dhe janë konstatuar se gjatë periudhës për vitin 2020 në këto rajone të mbuluara me pyje, janë shkaktuar prerje ilegale në disa lokacione, të cilave i kemi pranuar raportet nga komisioni i regjistrimit të terreneve.

Dyshimet e Inspektoratit prezencë të prerjeve ilegale të konstatuara gjatë kontrolleve rutinore janë vërtetuar edhe sipas raportit të komisionit për revizionim të terrenit pyjor, ndërkaq sipas Raportit të nxjerrë pas Vendimit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimit Rural në Ferizaj, me Procesverbal datë, 18/02/2021 kemi pranuar raportet e komisionit ku konstatohet se terrenet me pyje në K. Ferizaj kanë përfunduar me revizione të rëndomta për vitin 2020, konkretisht në terrenin Pleshin I, prerja është bërë sistematikisht me ç'rast ka shkaktuar dëmtim të pyllit me sasi dem pyjor me vëllim 330.03m³ të llojit drurit Ahu, prej të cilave të mbuluara me fletëparaqitje vetëm, 24.19m³, ndërsa 305.84m³ pa mbulesë me fletëparaqitje kryesisht drunj të diametrave (13-74) cm, në trung) gjë që kjo formë e prerjes është shkaktuar sipas dëshirës duke degraduar këto sipërfaqe pylli. Vlera e drurëve të prerë është 41,853.33 /€ euro.

Sipërfaqja e përfshirë nga prerjet ilegale dhe sasia e masës drunore të cilat komisioni ka konstatuar në terren janë të konsiderueshme si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin ekologjik, ndërkaq konstatohet se prerja është bërë sistematikisht për një periudhë jo të shkurtë kohore e cila ka shkaktuar dëmtim të pyllit.

Me këto veprime Roja pyllit [redacted] ka kryer veprë penale në bazë të Nenit 414 paragrafi 1 dhe 2 keqpërdorim i pozitës apo autoritetin zyrtar të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

Bazuar në Ligjin e Pyjeve, Ligjit nr.2003/3, dhe nr.03/L-153 Për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet e Kosovës, 2003/3, Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2010 Për Mbrojtjen e Pyjeve, Përgjegjësitë dhe Obligimet e Rojës së Pyllit të datës: 28.06.2010 neni 4, 5, 7, 16 (përgjegjësitë) dhe neni 24 pika 2, roja e pyllit është përgjegjës për përmbushje-zbatim të detyrës për mbrojtjen e pyllit për shkak të mos përmbushjes së detyrave ligjore që burojnë nga përshkrimi i detyrave të punës, rojtari i pyllit ka shkaktuar dëme ekonomike dhe mjedisore pyjeve si pasuri kombëtare metë cilat menaxhon Agjencia Pyjore Kosovës (APK) dhe administron pyjet dhe tokat pyjore publike, ndërkaq mbrojtja e pyjeve në bazë të ligjit nr.03/L-153 Për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Pyjet e Kosovës, 2003/3 Mbrojtja e pyjeve si kompetencë delegohet nëpër komuna

Propozim:

Me që ekziston dyshimi i bazuar se z. [redacted] roje pylli ka kryer veprën penale, keqpërdorim i pozitës apo autoritetin zyrtar, Inspektorati i Pylltarisë dhe Gjuetisë, paraqet këtë Kallëzim Penal Prokurorisë Themelore në Ferizaj, që të ngrit Aktakuzë, e që pastaj Gjykata Themelore pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të të gjitha provave, kryesin e veprës ta shpallë fajtor dhe t'ja shqiptoj dënimin meritor konform KPPK-së si dhe dispozitave të Ligjit mbi Pyjet të Kosovës Nr.2003/03, të datës 13 Shkurt 2003, ta obligoj për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj APK-ës.

Prove:

1. Vendimi për revizion i Drejtorisë për BPZHR. -Ferizaj me nr. 156/2019 dt.24/10/19
2. Raportin e Komisionit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari në Ferizaj dhe DKR-Ferizaj, me Nr. Protokoli 11.Nr.134/2020

Z. Murat Rukolli

Udhëheqës i Sektorit të Inspektimit
për Pylltari në DQIPGJ të APK-së

Mehdi Berisha

Inspektore e Pylltarisë në DQIPGJ.